

BIBLIOTEKA

E

854-1
9/58

SHIETITI

GJIROKASTER

INDOC
GUETJA

Rrezatim
Poezi


819.983-1
9.58

NDOC GJETJA

RREZATIM

(Lirika)

~~56335~~



12504

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

BASHKATDHETAREVE

Në luftë apo në punë, mes njerëzve të qeshur,
do ta mbyll një ditë kapitullin e jetës sime,
në buzë do të lë ndonjë frazë të pashprehur,
dhe në kokë ndonjë motiv të bukur poezie.

Dhe kur të kridhem në gjirin e tokës nënë
i mbështjellur me pelerinën e përjetshme të
heshtjes.

do doja që për mua bashkatdhatarët të thonë:
— Ai na deshi me gjithë fuqinë e zemrës! . . .

NÉ SYTÉ E MI

Afrojeni kokën te këto dritare me xhamat të
tejdukshëm, pa perde të errta,
të shikoni brendësinë time të ndritshme;
ja korridori ku kam shtruar qilimat e ëndrrave dhe
shpresave me ngjyra të ndezura;

ja salloni i hapur për dashurinë;
ja tabela e kuqe te hyrja
ku këm shkruar fjalët: «Mirë se vini!»,
Mbi qilimat e ëndrrave s'lejoj të pështyjë kush
dhe të ecë brutalisht me hap ciniku.

INVALIDI I LUFTËS

Unë do të hyj pa trokitur në të gjitha dyert e
shekujve
duke mbajtur pranë zemrës teserën e kuqe,
duke tundur përballë lumturisë suaj të gjitha plagët
e tmerrshme
që mora për ju, nëpër shtigje lufte.

Dy mëngët e xhaketës do më varen boshe,
mos m'i shtrini duart se s'mund t'ua shtrëngoj, o
nipa,
si peng ja dhashë lirisë një ditë në llogore
të dyja duart që kisha.

Do të hyj mes jush e do ta ngul shikimin tim zhbirues,
të shoh nëse rron kujtimi im në zemrat tuaja,
përndryshe do të jem më i tmerrshmi akuzues.
për plagët që mora... për duart që humba...

BJONDËS GAZMORE NË SFOND TË MUREVE TË LASHTË

Një kokë e qeshur bjonde në sfond të mureve të sertë
e të lashtë
m'u shfaq si imazh i bardhë i lumturisë sime të
ardhme.
— Për një kokë të tillë u shemb Troja krejt —
thashë —
e ra mbi kokat e trojanëve.

M'u duk sikur erdhi nga thellësitë e kohërave tragjike
si imazh fluid i pakapshëm, kjo vajzë e qeshur, sonte;
për ta rrëmbyer s'do më duhet të shemb kështjella
me mure qiklopike,
por dobësinë e shpirtit, që quhet ndrojtje.

Për një kokë bjonde, sipas mitit, grekët hodhën në
luftë mijëra ushtarë,

e bënë aq krime që s'do shuhen kurrë në kujtesë të
breznive,
kurse ty, o vetja ime, të mungon guximi t'i thuash dy
fjalë
bjondines gazmore që të qesh para syve...

TOKËS

Rrudhat e mia —
rrudhat e tua.
Unë jam rrudhur për ty,
ti je rrudhur për mua...

M'u desh të marr shumë plagë në trup,
dhe ta lag me gjak tabanin tënd të fortë,
që unë të bëhem i yti bujk,
që ti të bëhesh e imja tokë.

MËNGJEZ NË ALPET E VERIUT

Lisat dirigjentë. Krojet simfoni.
Kor'i zogjve ëmbël shpërthen.
Mbi kurrise malesh dielli kokën zgjati
me buzëqeshje të kuqe si djalosh çapkën.

Nëpër shkallë tarracash ngjitem ngadalë
sikur shkoj të puthem buzë për buzë me diellin.
Në thellësi të shpirtit më përvlon një mall:
— Sikur të kisha me vete Migjenin! ...

Mbi këtë shkëmb të rrnim një copë herë,
duke shikuar këta tela që rendin tutje;
do ta kënaqte ky peisazh me diell,
blokun do ta mbushte me lirika të gëzueshme.

ANTIFETARE

Me këto duar të ashpra, të forta,
grisa ungjij e theva ikona,
përmbysa tempuj e dogja rite
edhe ua hodha në surrat priftrinjve.

Kur «zoti» dëgjoi kërdinë që bëra,
më dërgoi memorandum.
Ai më drejtohej më fjalë të ashpra:
— I ziu, ti, kur të vih tek unë! . .

Dhe unë «zotit» i çova letër,
e ju përgjegja me rreptësi:
— Unë s’do vij në botën tjetër,
në botën time unë do të rr*i*.